

**FONDI KOSOVAR PËR GARANCI  
KREDITORE**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare për vitin që ka  
përfunduar më 31 Dhjetor 2023**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
<b>Raporti i Auditorit të Pavarur</b>	<b>1</b>
<b>Pasqyra e Pozicionit Financiar</b>	<b>3</b>
<b>Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse</b>	<b>4</b>
<b>Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e Rrjedhës së Parasë</b>	<b>6</b>
<b>Shënimet e Pasqyrave Financiare</b>	<b>7-42</b>
<b>Shtojca 1 - Transaksionet e Projektit për Mbështetje dhe Forcim Financiar</b>	<b>43</b>

## RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

### Për Bordin e Drejtorëve të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore

#### Raport i auditimit të Pasqyrave Financiare

##### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditore ("Fondi" apo "FKGK"), që përfshinë: Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2023, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar dhe shënimet e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe një përmbledhje të informatave për politikatat materiale të kontabilitetit.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Fondit më 31 Dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që kanë përfunduar në përputhshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

##### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

##### Raportimi për informacione të tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informacione të tjera të shpalosura në Aneksin 1 të këtyre pasqyrave financiare. Informacioni tjetër përbëhet nga grafiku që shpalos bilancet dhe transaksionet me Bankën Botërore.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacione të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë formë të konkluzionit të sigurisë mbi to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër dhe duke e bërë këtë të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose ndryshe duket të jetë materialisht i gabuar.

##### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondit për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Fondin apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

## Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Fondit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësimi i prezantimit në përgjithësi, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë informatat e paraqitura, si dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në atë mënyrë që përbënë prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Ky raport në Shqip është version i përkthyer i origjinalit në gjuhën Angleze, në rast të mospërputhjeve, origjinali në Anglisht do të mbizotëroj.



Amir Dërmata  
Partner i Angazhimit  
BDO Kosova L.L.C.  
25 Qershor 2024  
Ukshin Hoti, Ndërtesa C 4/3, Hyrja. A, Kati 2,  
Prishtinë, Kosovë

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore  
Pasqyra e Pozicionit Financiar  
Më 31 dhjetor 2023  
(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)

		Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
	Shënime		
<b>PASURITË</b>			
Prona, impiantet dhe pajisjet	9	38,234	30,954
Pasuritë e paprekshme	10	22,147	17,509
Pasuritë me të drejtë përdorimi	8	22,210	41,248
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>82,591</b>	<b>89,711</b>
Depozitat	6	55,932,554	42,174,250
Investimet në letra me vlerë	7	22,926,628	18,781,139
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	5	335,651	282,333
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	8,668,321	2,052,322
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>87,863,154</b>	<b>63,290,044</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>87,945,745</b>	<b>63,379,755</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
Kapitali	13	76,932,511	54,300,921
Fitimi i akumuluar		4,360,451	3,434,390
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>81,292,962</b>	<b>57,735,311</b>
Shpenzimet akruale		101,434	11,553
Detyrimet e qirasë	8	24,920	44,891
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>126,354</b>	<b>56,444</b>
Rezervat e humbjeve nga garancionet e kredive	19	4,566,250	3,021,000
Të hyrat e shtyra	11	829,840	1,346,980
Tarifat akruale të garancisë	12	1,130,339	1,220,020
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>6,526,429</b>	<b>5,588,000</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>6,652,783</b>	<b>5,644,444</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>87,945,745</b>	<b>63,379,755</b>

Autorizohet për lëshim nga menaxhmenti dhe nënshkruar në emër të tij më 25 Qershor 2024.

  
Besnik Berisha  
Drejtor Menaxhues



  
Vjosa Balaj  
Menaxhere e Lartë e Financave

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore  
Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse  
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

		Për vitin që përfundon 31 Dhjetor 2023	Për vitin që përfundon 31 Dhjetor 2022
	<b>Shënime</b>		
Të hyra nga garancionet	14	2,374,801	2,457,527
Te hyra nga interesi	15	1,209,007	855,819
Të hyra tjera	16	474,325	368,359
<b>Fitimi bruto</b>		<b>4,058,133</b>	<b>3,681,705</b>
Shpenzimet e personelit	17	(335,474)	(287,630)
Shpenzimet operative	18	(262,596)	(297,530)
Shpenzimet e zhvlerësimit	9,10	(23,626)	(21,155)
Zhvlerësimi ROU	8	(19,038)	(19,038)
Neto provizionet për humbje nga garancionet	19	(2,397,124)	(269,387)
Neto provizionet për humbje nga pasuritë tjera	19	(91,985)	34,531
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>(3,129,843)</b>	<b>(860,209)</b>
Shpenzimet e detyrimeve të qirasë		(2,229)	(3,430)
<b>Neto fitimi për vitin</b>		<b>926,061</b>	<b>2,818,066</b>
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>926,061</b>	<b>2,818,066</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore**  
**Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Kapitali	Fitimi i akumuluar	Gjithsej
Bilanci më 1 Janar 2022	54,300,921	616,324	54,917,245
Neto fitimi për vitin	-	2,818,066	2,818,066
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2022</b>	<b>54,300,921</b>	<b>3,434,390</b>	<b>57,735,311</b>
Bilanci më 1 Janar 2023	54,300,921	3,434,390	57,735,311
Neto fitimi për vitin	-	926,061	926,061
Kapitali i paguar	22,631,590	-	22,631,590
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<b>Bilanci më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>76,932,511</b>	<b>4,360,451</b>	<b>81,292,962</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore**  
**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**  
**Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**  
*(të gjitha vlerat në EUR, përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2022
<b>Aktivitetet operative</b>		
Neto profiti për vitin, para tatimit	926,061	2,818,066
<i>Rregullimet për:</i>		
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	42,664	40,193
Humbjet nga shitja e pasurive	-	108
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>968,725</b>	<b>2,858,367</b>
Rritja në të arkëtueshme tregtare dhe tjera	(53,318)	(56,625)
Rritja/(zvogëlimi) në shpenzimet akruale	89,881	(1,543)
Ndryshimi në të hyrat e shtyra	(517,140)	(910,478)
Ndryshimi në akrualet e tarifave të garancisë	(89,681)	(106,566)
<b>Paraja neto e gjeneruar në aktivitetet operative</b>	<b>398,467</b>	<b>1,783,155</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Rritja në depozita	(13,758,304)	(5,038,340)
Rritja në letra me vlerë	(4,145,489)	(4,194,717)
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	(35,544)	(27,579)
Ndryshimi në rezervën për humbjet nga garancionet	1,545,250	(303,217)
Ndryshimi në rezervën për humbjet nga pasuritë tjera	-	(34,531)
<b>Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese</b>	<b>(16,394,087)</b>	<b>(9,598,384)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Zvogëlimi në detyrimet e qerasë	(19,971)	(18,770)
Kapitali i paguar	22,631,590	-
<b>Paraja neto e gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet financuese</b>	<b>22,611,619</b>	<b>(18,770)</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të parasë gjatë vitit</b>	<b>6,615,999</b>	<b>(7,833,999)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fillimi i vitit	2,052,322	9,886,321
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë, fundi i vitit</b>	<b>8,668,321</b>	<b>2,052,322</b>

Shënimet shoqëruese në faqet 7 deri 41 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.



## 1. TË PËRGJITHSHME

Fondi Kosovari për Garanci Kreditore ("FKGK" ose "Fondi") është institucion i pavarur dhe i qëndrueshëm që lëshon garanci për institucionet financiare për të mbuluar rrezikun për kreditë e NMVM-ve (Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme).

FKGK u krijua, përmes të një iniciative të përbashkët midis Donatorëve Ndërkombëtarë në Kosovë (kryesisht USAID dhe KfW) dhe Qeverisë së Kosovës, në Janar 2016, bazuar në Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovari për Garanci Kreditore.

Ligji për Themelimin e Fondit Kosovari të Garancisë Kreditore" (Ligji nr. 05/L-057), tutje referuar si LKCGF, krijoi Fondin Kosovari të Garancisë Kreditore (FKGK) si një institucion publik, autonom, jofitimprurës me personalitet të plotë juridik. Ky ligj e ndan në mënyrë të qartë identitetin ligjor të FKGK-së nga Bordi i Drejtorëve dhe Ekzekutivëve të tij. LKCGF gjithashtu përcakton autoritetin, strukturën, qeverisjen, operacionet, fushëveprimin, politikat dhe procedurat e FKGK-së për lëshimin e garancive kreditore.

Ligji për themelimin e FKGK-së u inicua nga MTI (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë), ndërsa USAID në Kosovë, përmes Programit EMPOWER Mbështetja e Kredisë (ECS) mbështeti institucionin për t'u bërë funksional. Ligji hyri në fuqi më 23 Janar 2016. Kapitali i FKGK-së përbëhet nga fonde të dhuruara nga USAID, KfW dhe Qeveria e Kosovës.

FKGK është krijuar për të ndihmuar në plotësimin e nevojës për qasje të shtuar në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në Kosovë, me qëllim të krijimit të vendeve të punës, rritjes së prodhimit vendor dhe shërbimeve të shtuara me vlerë, dhe përmirësimit të bilancit tregtar dhe rritjes së mundësive të financimit për NMVM-të.

FKGK udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve i përbërë nga shtatë anëtarë: Një anëtar i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Republikës së Kosovës; Një anëtar i emëruar sipas detyrës zyrtare nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës; katër anëtarë të pavarur, të emëruar nga donatorët, dhe Drejtori Menaxhues i FKGK-së, të cilët së bashku kombinojnë vite përvojë në menaxhimin financiar, menaxhimin e rrezikut, ligjin komercial ose financiar, sektorin privat dhe auditimin. Bordi ofron udhëheqje dhe mbikëqyrje për të gjitha aktivitetet e FKGK-së.

FKGK-ja është themeluar me qëllim të sigurimit të pjesshëm të garancive të kredive për institucionet financiare, për kreditë që i jepen NMVM-ve, deri në shumën e mbulimit garancioneve të kredive të përcaktuar me LFKGK dhe Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet FKGK-së dhe institucionit financiar.

Për qëllimet e veprimtarisë kryesore, FKGK-ja është përgjegjëse për:

- a. Lëshimin e Garancive Kreditore në përputhje me LFKGK-në dhe politikat e brendshme të miratuara nga Bordi i Drejtorëve.
- b. Vendosjen e kushteve për regjistrimin e institucioneve të kualifikuara financiare në FKGK, sipas Politikës për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja.
- c. Caktimin e kushteve për lëshimin e Garancive Kreditore nga FKGK-ja
- d. Caktimin e Tarifave të Garancive
- e. Depozitimin apo investimin e drejtpërdrejtë, apo përmes delegimit të autorizimeve, të aseteve të FKGK-së brenda kufizimeve të LFKGK-së
- f. Pagesën e Shumave të pagueshme për Garancitë Kreditore për institucionet financiare të regjistruara në pajtim me dispozitat e LFKGK-së dhe Marrëveshjes së Garancisë, në përputhje me dispozitat e LFKGK-së dhe Politikave për Trajtimin e Kërkesave.

## **1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)**

Kapitali minimal i FKKG-së është 300,000.00 Euro, sipas nenit të 10 të LFKGK (Ligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore). Organet qeverisëse të FKKG-së janë Bordi i Drejtorëve dhe Drejtori Menaxhues. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë drejtues i FKKG-së. Numri fiskal i FKKG-së është 601642061.

Operacionet e FKKG-së dhe të gjitha aktivitetet administrative janë të pavarura që nga data 10 qershor 2017 dhe janë nën menaxhimin e Fondit.

Më 6 Dhjetor 2017 Fondi për Garantimin e Kredive të Kosovës (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë. Më 14 maj 2019 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë me Fondin Evropian Investues nën programin COSME LGF (loan guarantee facility). Më 11 maj 2022, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e Garancisë së portofolit me Korporatën Financiare për Zhvillim (DFC). Më 30 nëntor 2023, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) nënshkroi Marrëveshjen e dytë të Garancisë me Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA), përfaqësuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë.

Mbështetja e portofolit të garantuar të FKKG-së nga Sida dhe COSME, dhe DFC do të rrisë më tej aftësinë e Fondit për të siguruar një nivel më të lartë të garancive të kredisë, duke rritur në të njëjtën kohë qëndrueshmërinë financiare të sektorit. Qëndrueshmëria do të reflektojë në lehtësimin e ndërmjetësimit financiar, duke rritur kështu qasjen në financimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, me qëllim të promovimit të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës për gra, burra dhe të rinjtë e të gjitha etnive në Kosovë.

## **2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT**

### **2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), siç janë nxjerrë nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Pasqyrat financiare janë përgatitur me anë të bazave të vlerësimit të specifikuar nga SNRF-ja për çdo lloj aset, detyrimi, të ardhurash apo shpenzimesh. Bazat e vlerësimit janë të përshkruara në hollësi në Shënimin si me poshtë. Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-në kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të kontabilitetit. Gjithashtu kërkon nga menaxhmenti të shfrytëzojë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Fondit. Fushat ku janë bërë gjykime dhe vlerësime të rëndësishme gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe efektet e tyre shpalosen në shënimin 3.8.

#### **2.1.1 *Adoptimi i Standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimi i tyre***

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara vijuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë efektive për periudhën aktuale të raportimit të cilat hyjnë në fuqi për një periudhë kontabël që fillon me ose pas datës 1 Janar 2023.

- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (përfshirë ndryshimet e qershorit 2020 dhe Dhjetorit 2021 në SNRF 17)**

SNRF 17 vendos parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e kontratave të sigurimit dhe shfuqizon SNRF 4 - Kontratat e sigurimit. SNRF 17 përshkruan një model të përgjithshëm, i cili modifikohet për kontratat e sigurimit me karakteristika të pjesëmarrjes direkte, të përshkruara si metoda e tarifave të ndryshueshme. Modeli i përgjithshëm thjeshtohet nëse përmbushen disa kritere duke matur përgjegjësinë për mbulimin e mbetur duke përdorur metodën e ndarjes së primeve. Modeli i përgjithshëm përdor supozimet aktuale për të vlerësuar sasinë, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parave të gatshme dhe mat në mënyrë eksplicite koston e kësaj pasigurie. Ai konsideron normat e interesit të tregut dhe ndikimin e opsioneve dhe garancive të mbajtësve të politikave.

## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.1.1 *Adoptimi i Standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimi i tyre (vazhdim)*

Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) ka marr vendim të shtyjë datën e zbatimit të SNRF 17 për tre vjet. Aplikimi i SNRF 17 - Kontratat e Sigurimit bëhet efektive për periudhat raportuese duke filluar nga ose pas datës 1 Janar 2026 për Republikën e Kosovës.

FKGK nuk ka asnjë kontratë që plotëson përcaktimin e një kontrate sigurimi sipas SNRF 17, kështu që menaxhmenti i Fondit parashikon që standardi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Fondit në periudhat e ardhshme.

- **Ndryshimet në SNK 12 - Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë që lidhet me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm**

Ndryshimet ngushtojnë objektin dhe japin qartësi të mëtejshme për përjashtimin e njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet nuk kanë pasur ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Fondit më 31 Dhjetor 2023.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikave të SNRF 2: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshime)**

Ndryshimet ofrojnë udhëzime për zbatimin e gjykimeve të materialitetit në dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël. Në veçanti, ndryshimet në SNK 1 zëvendësojnë kërkesën për të dhënë informacione shpjeguese për politikat kontabël "të rëndësishme" me një kërkesë për të dhënë informacione shpjeguese për politikat kontabël "materiale".

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023 me aplikim të mëhershëm të lejuar. Ndryshimet nuk kanë pasur ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit.

- **SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime)**

Ndryshimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë në matje, nëse ato nuk rezultojnë nga një korrigjim i gabimit të periudhës së mëparshme. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si ndryshojnë këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve.

Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2023 me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Ndryshimet nuk kanë pasur ndikim në pasqyrat financiare të Fondit.

## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.1.2 Standardet dhe interpretimet e reja dhe të rishikuara të lëshuara nga BSNK por ende jo efektive dhe të pa miratuara më herët

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, FKGK nuk ka zbatuar standardet dhe interpretimet e reja dhe të rishikuara të raportimit financiar që janë publikuar por nuk janë ende efektive.

- Ndryshimet në SNK 1 - Paraqitja e pasqyrave Financiare- Klasifikimi i detyrimeve afatshkurta ose afatgjata
- Ndryshimet SNK 7 dhe SNRF 7 në marrëveshjet financiare të furnizuesve
- Ndryshimet në SNRF 16 Përgjegjësia e qirasë në shitje dhe qiradhënie

Menaxhmenti i Fondit nuk pret që miratimi i Standardeve të listuara më sipër të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit në periudhat e ardhshme.

- **Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare - Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata**

Në Janar 2020 dhe tetor 2022, BSNK publikoi ndryshime në paragrafët 69 deri në 76 të SNK 1 për të specifikuar kërkesat për klasifikimin e detyrimeve si afatshkurta dhe afatgjata. Objektivi i ndryshimeve është të qartësojë parimet në SNK 1 për klasifikimin e detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë. Ndryshimet sqarojnë kuptimin e një të drejte për të shtyrë shlyerjen, kërkesën që kjo e drejtë të ekzistojë në fund të periudhës raportuese, që qëllimi i menaxhmentit të mos ndikojë në klasifikimin afatshkurtër ose afatgjatë, se opsionet nga pala tjetër që mund të rezultojnë në shlyerje nga transferimi i instrumenteve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike nuk ndikojnë në klasifikimin afatshkurtër ose afatgjatë. Ndryshimet specifikojnë se vetëm marrëveshjet me të cilat një entitet duhet të pajtohet në ose përpara datës së raportimit do të ndikojnë në klasifikimin e një detyrimi. Gjithashtu kërkohen dhënie informacionesh shpjeguese shtesë për detyrimet afatgjata që rrjedhin nga marrëveshjet e huas që i nënshtrohen marrëveshjeve që duhet të respektohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janari, 2024 ose pas 1 Janarit 2024, dhe duhet të zbatohet në mënyrë retrospektive. FKGK do të vlerësojë ndikimin që ndryshimet mund të kenë në praktikën aktuale.

- **Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7 - Marrëveshjet financiare të furnizuesve**

Në maj 2023, BSNK publikoi ndryshime në SNK 7 Pasqyra e Rrjedhjes së pasasë dhe SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese për të sqaruar karakteristikat e marrëveshjeve financiare të furnizuesit dhe kërkon shpallje shtesë të marrëveshjeve të tilla. Kërkesat për shpallje në ndryshimet e standardeve kanë për qëllim të ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare në kuptimin e efekteve të marrëveshjeve financiare të furnizuesve mbi detyrimet e një entiteti, rrjedhjet e parave të gatshme dhe ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

Ndryshimet do të jenë efektive për periudhat vjetore raportuese duke filluar nga ose pas datës 1 Janar 2024. Ndryshimet nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Fondit.

- **Ndryshimet në SNRF 16: Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthimi me qira**

BSNK publikoi ndryshime në SNRF 16 për të specifikuar kërkesat që përdor një shitës-qiramarrës në matjen e detyrimit të qirasë që lind nga një transaksion shitje dhe kthimi me qira, ndërkohë që nuk ndryshon kontabilitetin për qiratë që nuk lidhen me transaksionet e shitjes dhe të kthimit me qira.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit duke filluar nga ose pas 1 Janarit 2024 dhe duhet të aplikohen në mënyrë retrospektive në transaksionet e shitjes dhe kthimit me qira të vendosura pas datës së aplikimit fillestar të SNRF 16. Ndryshimet nuk pritet të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Fondit.

## **2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

### **2.2 Asetet Financiare dhe Detyrimet Financiare**

Në shikim fillestar, një aset financiar klasifikohet si i matur me koston e amortizuar, FVOCI, ose FVTPL. Detyrimet financiare klasifikohen dhe maten me koston e amortizuar.

Një aset financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- aset mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë asete për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të asetit financiar i japin rritje rrjedhës së parasë në data të specifikuar që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të principalit mbi shumën e mbetur.

Një instrument borxhi matet në FVOCI vetëm nëse i plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në FVTPL:

- aset mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- Kushtet kontraktuale të asetit financiar japin ngritje në datat e specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

Në shikim fillestar, FKGK mat një aset ose detyrim financiar në vlerën e tij të drejtë plus ose minus, në rastin e një aseti ose detyrimi financiar jo me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, kostot e transaksionit që janë shtesë dhe i atribuohen drejtpërdrejtë blerjes ose lëshimit të asetit ose detyrimit financiar, siç janë tarifat dhe komisionet.

Më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, asetet dhe detyrimet financiare të Fondit maten me pas me koston e amortizuar dhe përfshijnë paratë dhe ekuivalentët e saj, depozitat, letrat me vlerë, të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera dhe detyrime të tjera. Legjislacioni i humbjeve për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si një zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve. Llogaritja e ECL për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar është paraqitur në shënimin 2.13.

Asetet financiare, ose një pjesë e tyre, çregjistrohen kur të drejtat e kontratës për të pranuar rrjedhën e parasë nga asetet kanë skaduar. Detyrimet financiare çregjistrohen kur shuhet (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet, ose skadon).

### **2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe balancat në bankë me një maturim origjinal prej më pak se 3 muaj. Fondi ka llogari bankare të hapur në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe llogari rrjedhëse me Bankën për Biznes, Bankën Ekonomike, TEB Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Pro Credit Bank dhe NLB Bank.

## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.4 Prona, Impiantet dhe Pajisjet

Në pasqyrat financiare, prona, impiantet dhe pajisjet maten me koston historike të blerjes minus amortizimi i akumuluar dhe humbja nga zhvlerësimi.

#### *Njohja fillestare*

Pas blerjes së tyre fillestare të pronës, impiantet dhe pajisjet vlerësohen me koston e blerjes, e cila përfshin çmimin e blerjes, përfshirë tarifat doganore dhe çdo kosto që i atribuohet drejtpërdrejtë për sjelljen e asetit në gjendje pune. Kostot e atribueshme drejtpërdrejtë përfshijnë kostot për përgatitjen e vendit, kostot fillestare të dorëzimit dhe trajtimit, kostot e instalimit, tarifat profesionale për njerëzit e përfshirë në projekt, taksat e pakthyeshme, etj.

Qasja e zgjedhur nga Kompania për matjen e pasuese të pasurive, impianteve dhe pajisjeve, është modeli i koston nën SNK 16 - kostoja e blerjes është më e vogël se çdo amortizim i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga zhvlerësimi.

Fitimet ose humbjet nga çregjistrimi i një zëri të pronës, impianteve dhe pajisjeve (të llogaritura si diferenca midis të ardhurave dhe vlerës së mbartur të sendit) njihen neto brenda të ardhurave/ kostove të tjera në fitim ose humbje.

#### *Metodat e Zhvlerësimit*

Fondi aplikon metodën e zhvlerësimit të linjës së drejtpërdrejtë për pronat, impiantet dhe pajisjet si më poshtë:

(i) Pajisje dhe pajisje të TI-së	3 vite (shfrytëzueshmëri)
(ii) Mobile të zyrës	3 vite (shfrytëzueshmëri)
(iii) Përmirësimet ne objekt	sipas kontratës së qirasë

### 2.5 Asetet e paprekshme

Në pasqyrat financiare, asetet e pa prekshme vlerësohen me kosto më të vogël të amortizimit të akumuluar dhe humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Ato përfshijnë programe softuerësh dhe licenca për përdorimin e tyre. Fondi zbaton metodën e zhvlerësimit në linjë të drejtpërdrejtë për asetet e pa prekshme me një jetë të dobishme të përcaktuar 5 vjet.

### 2.6 E drejta e përdorimit të asetit

Fondi njih një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë përdorimi fillimisht matet me kosto, që përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë rregulluar për çdo pagesë qiraje të bërë në ose para datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të bërë dhe një vlerësim të kostove për të çmontuar dhe hequr aktivin themelor ose për të rivendosur aktivin themelor ose faqen në të cilën ndodhet, minus çdo stimul i marrë me qira.

Pasuria me të drejtë përdorimi zhvlerësohet më pas duke përdorur metodën drejtvizore nga data e fillimit deri më herët në fund të jetës së dobishme të pasurisë me të drejtë përdorimi ose në fund të afatit të qirasë.

## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.6 E drejta e përdorimit të asetit (vazhdim)

Jeta e dobishme e vlerësuar e pasurive me të drejtë përdorimi përcaktohet në të njëjtën bazë me ato të pronës dhe pajisjeve. Për më tepër, Pasuria me të drejtë përdorimi zvogëlohet periodikisht nga humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet për disa matje të detyrimit të qirasë.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, zbriten duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira ose, nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, norma rritëse e huamarrjes së Fondit.

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë sa vijon:

- pagesa fikse, përfshirë pagesat fikse në thelb.
- pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose një normë, fillimisht e matur duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit.
- shumat që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur; dhe
- çmimi i ushtrimit nën një opsion blerjeje që Kompania është e arsyeshme e sigurt për të ushtruar, pagesa qiraje në një periudhë opcionale rinovimi nëse Kompania është e arsyeshme e sigurt për të ushtruar një opsion zgjatjeje dhe gjordat për përfundimin e hershëm të një qiraje përveç nëse Kompania është e arsyeshme e sigurt të mos përfundojë herët.

Detyrimi i qirasë matet me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Ajo matet përsëri kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Fondit të shumës që pritet të paguhet nën një garanci të vlerës së mbetur, ose nëse Fondi ndryshon vlerësimi nëse do të ushtronte një mundësi blerjeje, zgjatjeje ose përfundimi.

Kur detyrimi i qirasë rimatet në këtë mënyrë, një rregullim përkatës bëhet në vlerën kontabël të Pasurisë me të drejtë përdorimi ose regjistrohët në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e aktivitetit të së drejtës së përdorimit është zvogëluar në zero.

Fondi paraqet pasuritë me të drejtë përdorimi që nuk përmbushin përkufizimin e pasurive afatgjatë material të investuar në “pasuritë afatgjata materiale dhe pajisjet” dhe detyrimet e qirasë në “detyrimet e tjera” në pasqyrën e pozicionit financiar.

Me kalimin në SNRF 16, norma mesatare e ponderuar e rritjes së huamarrjes e aplikuar për pasivët e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 6.4%.

Fondi përdor një ose më shumë nga ekspeditat e mëposhtme praktike sipas SNRF 16.C10, duke e zbatuar atë mbi bazën e qirasë:

- Përdorimi i një norme të vetme skontimi në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme.
- Rregullimi i asetit të së drejtës së përdorimit për çdo provizion të njohur me qira të rëndë, në vend të kryerjes së një rishikimi të zhvlerësimit.
- Zbatimi i një përjashtimi nga njohja për qira për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qirasë së aktiveve me vlerë të ulët. Kompania njej pagesat e qirasë të shoqëruara me këto qira si një shpenzim mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.
- Përjashtimi i kostove fillestare direkte nga matja e asetit të së drejtës së përdorimit.
- Përdorimi i mendimeve të menjëhershme, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

## **2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)**

### **2.6 E drejta e përdorimit të asetit (vazhdim)**

Në fillimin e një kontrate, Kompania vlerëson nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse kontrata përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë në këmbim të vlerësimit. Për të vlerësuar nëse një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Kompania vlerëson nëse:

- kontrata përfshin përdorimin e një aktivi të identifikuar - kjo mund të specifikohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar dhe duhet të jetë fizikisht e veçantë ose të përfaqësojë në thelb të gjithë kapacitetin e një aktivi fizikisht të dallueshëm. Nëse furnizuesi ka një të drejtë substanciale zëvendësimi, atëherë aktivi nuk identifikohet.
- Kompania ka të drejtë të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i asetit gjatë gjithë periudhës së përdorimit; dhe
- Kompania ka të drejtë të drejtojë përdorimin e asetit. Kompania ka këtë të drejtë kur ka të drejtat e vendimmarrjes që janë më të rëndësishme për të ndryshuar mënyrën dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi. Në raste të rralla kur vendimi se si dhe për çfarë qëllimi është përdorur aktivi është i paracaktuar, Kompania ka të drejtë të drejtojë përdorimin e asetit nëse:
  - Kompania ka të drejtë të operojë asetin; ose
  - Kompania e projektoi asetin në një mënyrë që paracakton se si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret.

Kjo politikë zbatohet për kontratat e lidhura, ose ndryshuara, në ose pas 1 Janarit 2019.

### **2.7 Zhvlerësimi i aseteve jo-financiare**

Vlera kontabël e aseteve jo-financiare vlerësohet për zhvlerësim kur ndryshojnë ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera kontabël nuk mund të rikuperohet. Nëse ekzistojnë indikacione të tilla dhe kur vlera kontabël tejkalon shumën e vlerësuar të rikuperueshme, aktivet regjistrohen në shumën e rikuperueshme të tyre. Shuma e rikuperueshme e aseteve të tilla është më e madhe e çmimit neto të shitjes dhe vlerës së përdorimit. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën kohore të parave dhe rreziqet specifike për asetet.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

### **2.8 Bilanci i Fondit**

Bilanci i fondit është grant i ofruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, USAID dhe KfW.

### **2.9 Tatimi në të ardhura aktuale dhe të shtyra**

Sipas Ligjit për themelimin e FKGK-së (LFGKGK), Fondi është i përjashtuar nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, TVSH-ja dhe tatimi mbi dividendët, interesat ose të ardhurat nga investimet e fituara nga fondet për garancitë ose investimet e kreditit, si dhe çdo detyrim tjetër, mbajtje në burim ose taksë për çdo aspekt të veprimtarisë së Fondit.



## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.10 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet njihen kur plotësohen këto kushte:

- Shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.
- Është e mundshme që përfitimet ekonomike që lidhen me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike.
- Faza e përfundimit të transaksionit në datën e pasqyrës së pozicionit financiar mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
- Kostot e kryera për transaksionin dhe koston e kryerjes së transaksionit mund të maten në mënyrë të besueshme.

Te ardhurat e Fondit janë:

- (i) Të ardhurat nga tarifat e garancive
- (ii) Interesi nga Investimet

#### **Tarifat e Garancisë**

Pasi që kredia të pranohet dhe të vihet nën garanci, kalkulohet gjithashtu edhe tarifa e garancisë. Tarifa e garancisë kalkulohet në bazë të përqindjes aktuale të garancisë të përcaktuar për një Marrëveshje Garancie shumëzuar me shumën e aprovuar të garancisë. Të ardhurat nga tarifa e garancisë njihen në bazë të përllogaritjes për një periudhë prej 12 muajsh. Tarifat e garancisë njihen si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në fund të çdo muaji duke debituar akrualin e Tarifës së Garancisë dhe kredituar Tarifën e Garancisë.

#### **Interesi nga investimet**

Investimi nënkupton investimet e fondeve të tepërta ku parimi kryesor që udhëheqë investimin e këtyre fondeve është të sigurojë që objektivat parësore të ruajtjes së aseteve të FKGK-së dhe kufiri i rrezikut të tij janë të balancuara me arritjen e një kthimi të kënaqshëm.

### 2.11 Shpenzimet

Shpenzimet e FKGK-së janë:

- (i) Shpenzimet e ri-garantimit (tarifat e paguara për një ri-garancion)
- (ii) Shpenzimet operative (shpenzimet e përgjithshme administrative)
- (iii) Shpenzimet e personelit (pagat, tarifat e bordit)
- (iv) Shpenzimet e provizionit (provizionit për humbjet e garancisë)

Fondi regjistron shpenzimet nën bazën akruale të kontabilitetit. Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve paraqet të ardhurat/humbjet neto gjatë periudhës së llogaritjes, e cila transferohet në fitimin e akumuluar si pjesë e kapitalit të fondit. FKGK paguan vetëm kontribute në një plan pensionesh të administruar publikisht mbi baza të detyrueshme. Fondi nuk ka detyrime shtesë për pagesa pasi të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzime të përfitimit të punonjësve kur ato do të paguhen.

### 2.12 Donacionet

KCGF pranon donacione ose ndihmë teknike nga donatorët. Në kornizën e Asistencës Teknike, KCGF merr fonde dhe shpenzime të specifikuara në kontratë, asete fikse ose jo-materiale dhe ndërtimin e kapaciteteve. KCGF llogaritë shumat e marra në varësi të specifikave të kontratës si të hyra të shtyra dhe vetëm pas realizimit të tyre i regjistron ato në të hyrat e dhurimit në Pasqyrën e të Ardhurave.

## 2. INFORMACION PËR POLITIKAT MATERIALE TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.13 Provizionit për rënien në vlerë

Politika e provizionit specifikon procesin e lënies anash të rezervave të caktuara për të gjitha kreditë që vihen nën garancinë, e që priten të kenë apo mund të kenë pasur humbje kreditore. Në vitin 2021, FKGGK ka përmirësuar modelin i cili llogarit të dhënat historike të FKGGK-së të përshtatura nga modeli makroekonomik për të nxjerrë humbjet e pritshme në portofolin e garantuar, i cili është në përputhje me kërkesat e SNRF 9. Llogaritjet ECL bazohen në parametrat e mëposhtëm të hyrjes:

- *Probabiliteti i dështimit (PD)*: Kjo shpreh gjasat e mospagimit të vlerësuar në kushtet ekonomike mbizotëruese në datën e raportimit, e rregulluar për të marrë parasysh vlerësimet e kushteve ekonomike të ardhshme që ka të ngjarë të ndikojnë në rrezikun e mospagimit, gjatë një horizonti kohor të caktuar, d.m.th., mbi 12 muaj për ekspozimet e fazës 1 dhe gjatë gjithë jetës për ekspozimet e fazës 2 dhe 3.
- *Ekspozimi në dështim (EAD)*: Ky është një vlerësim i ekspozimit në një datë të mospagimit të ardhshëm, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë shlyerjet e principalit dhe interesit dhe tërheqjet e pritshme për objektet e zotuar. Për Garancitë, EAD do të bazohet në shumën e garantuar të papaguar.
- *Dështimi i dhënë nga humbja (LGD)*: Ky përfaqëson një vlerësim të humbjes që rrjedh nga një ngjarje e mospagimit. Ai bazohet në diferencën midis flukseve monetare kontraktuale të detyrimeve dhe atyre që huadhënësi do të priste të merrte.

Zhvlerësimi i garancive të kredisë sipas modelit bëhet në tre faza, bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare.

Parimi udhëzues i SNRF 9 është se Humbjet e Pritshme të Kredisë (HPK) pasqyrojnë modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë së kredisë. Shuma e ECL-së e njohur si provizion ose humbje varet nga shkalla e përkeqësimit të kredisë që nga njohja fillestare.

Sipas qasjes së përgjithshme, ekzistojnë dy baza matëse:

- HPK 12-mujore (Faza 1), e cila vlen për të gjitha pikat (nga njohja fillestare) për sa kohë që nuk ka ndonjë përkeqësim të ndjeshëm në cilësinë e kredisë.
- HPK e përvetshme (Faza 2 dhe 3), e cila zbatohet kur një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë ka ndodhur në baza individuale ose kolektive.

**Faza 1** - përfshin identifikimin e instrumenteve financiare që nuk janë përkeqësuar. Për këto instrumente, humbjet e pritura të kredisë prej 12 muajsh do të njiheshin. Kjo do të thotë, një vlerësim do të bëhet për mundësinë e një mospagimi që ndodh në 12 muajt pas datës së raportimit. Ky probabilitet do të shumëzohet me mungesën e rrjedhës së parave të jetëgjatësisë (d.m.th., vlerën e tanishme të diferencës së të gjithë principalit dhe interesit me kontratë dhe shumën që njëzia ekonomike pret të marrë) Në thelb, humbjet e pritshme të kredisë 12 muaj përfaqësojnë një pjesë të humbjeve të kredisë gjatë jetëgjatësisë.

**Faza 2** - përfshin identifikimin e instrumenteve financiare që janë përkeqësuar ndjeshëm në cilësinë e kredisë që nga fillimi i njohjes, dhe nuk shfaqin prova objektive të një ngjarje të humbjes së kredisë. Për këto instrumente, humbjet e pritshme të jetëgjatësisë do të njiheshin; të ardhurat nga interesi do të llogariteshin akoma në vlerën kontabël bruto për këto instrumente. Në ndryshim nga humbjet e pritura të kredisë 12-mujore, humbjet e pritshme të kredisë përfaqësojnë vlerësime të bazuara në mundësinë e një ngjarje të paracaktuar që ndodh në çdo kohë gjatë jetës së një instrumenti dhe nuk matet vetëm nga gjasat e ngjarjeve të mundshme të përcaktuara gjatë 12 muajve të ardhshëm.

**Faza 3** - është për ato instrumente financiare që tregojnë prova objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit. Për instrumente të tilla, humbjet e pritshme të kredisë njihen, por ndryshe nga aktivet financiare në fazat 1 ose 2, të ardhurat nga interesi për këto aktive llogariten në vlerën neto kontabël (d.m.th. vlera e mbartur bruto më pak humbjen e humbjes për humbjet e pritura të kredisë).

## 2. POLITIKAT E RËNDSISHME TË KONTABILITETIT (VAZHDIM)

### 2.13 Provizioni për rënien në vlerë (vazhdim)

Gjithashtu, ECL llogaritet edhe për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar (Depozita dhe letra me vlerë). Llogaritja e ECL për asetet financiare bazohet në vlerësimet e jashtme ku për secilën palë FKGK cakton një vlerësim. Meqenëse Kosova nuk ka një vlerësim, as institucionet financiare të depozitave nuk janë të vlerësuara, është përdorur vlerësimi më i fundit i Shqipërisë.

### 2.14 Kontingjentet dhe zotimet

Detyrimet kontingjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato zbulohen vetëm nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aset kontingjent nuk njihet në pasqyrat financiare por zbulohet kur një fluks i përfitimeve ekonomike është i mundshëm. Shuma e humbjes kontingjente njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë një detyrim të shkaktuar në datën e gjendjes financiare si dhe mund të bëhet vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes që shkaktohet.

### **3. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR**

#### **3.1 Hyrje dhe të përgjithshme**

Risku përkufizohet si efekt i ngjarjeve të pasigurisë dhe rezultateve të tyre që mund të kenë efekt të rëndësishëm tek operacionet e FKGK-së. Menaxhimi i riskut është procesi i vlerësimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me qëllim të reduktimit të atyre rreziqeve deri në nivele të pranueshme. Vlerësimi i riskut bazohet në identifikimin e kërcënimeve, si dhe gjasat që ato kërcënime të realizohen dhe ndikimin e tyre potencial mbi FKGK-në. Menaxhimi i riskut përdor rezultatet e vlerësimeve të rrezikshmërisë për të marrë vendime dhe për të koordinuar aktivitetet për të drejtuar dhe kontrolluar një organizatë në lidhje me riskun.

Politika e Menaxhimit të Riskut e FKGK-së përcakton parimet kryesore për të krijuar një sistem të përshtatshëm të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të riskut. Parimet themelore për menaxhimin e riskut janë të reflektuara në Marrëveshjen e Garancisë, në politikat dhe procedurat ekzistuese, si dhe tek metodologjitë dhe instrumentet për matjen, monitorimin dhe raportimin e riskut. Së bashku, këto formojnë strukturën e menaxhimit të riskut të FKGK-së.

#### **3.2 Struktura e Menaxhimit të Riskut**

Struktura e menaxhimit të riskut të FKGK-së thekson mbikëqyrjen dhe kontrollin e riskut, si dhe përcakton proceset dhe mekanizmat më të cilët merren dhe zbatohen vendimet për rreziqe. Struktura e menaxhimit të rrezikut të FKGK-së fillon me mbikëqyrjen nga Bordi i Drejtorëve. Bordi merr informata të rregullta mbi rreziqet kryesore të FKGK-së bashkë me një përmbledhje gjithëpërfshirëse të profilit të riskut dhe efektshmërisë së portofolit kundrejt qëllimeve të përcaktuara, që i prezantohet në baza tremujore Bordit. Bordi përcakton nivelet maksimale të riskut për rrezikun kreditor dhe rrezikun e likuiditetit, si dhe miraton politikat, kufizimet dhe strategjitë. Bordi gjithashtu siguron që FKGK-ja po merr masat e duhura për të arritur një baraspeshë të kujdesshme ndërmjet riskut dhe përfitimit.

Bordi i Drejtorëve ka themeluar dy komitete për të mbikëqyrur fushat specifike si dhe për të përgatitur temat për shqyrtim nga Bordi: Komiteti i Menaxhimit të Riskut dhe Komiteti i Auditimit.

Komiteti për Menaxhimin e Riskut - komiteti shqyrton dhe dorëzon rekomandime tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me nivelin maksimal të riskut të FKGK-së, politikat e riskut, udhëzimet për riskun, kapitalin, leverazhin, likuiditetin, produktet dhe shërbimet nga këndvështrimi i riskut, si dhe cilësinë kreditore të portofolit të kredive.

